

Paga bazë

Përditësimi i fundit 11 Mars 2025

Me pagë kuptohet **paga bazë**, si dhe shtesat me karakter të përhershëm. Nuk konsiderohen si pjesë përbërëse të pagës shpërblimet që merr punëmarrësi për shpenzimet e kryera për shkak të veprimtarisë së tij profesionale (Neni 109 KP).

Vlera e pagës mund të përllogaritet në kohë, sipas punës së kryer (pagë në njësi, në detyrë ose me komision) ose sipas rezultateve të ndërmarrjes (me pjesëmarrje në fitim ose në xhiron e të ardhurave).

Vlera e pagës, jo në bazë të kriterit kohë, duhet të llogaritet në mënyrë që t'i japë mundësi punëmarrësit me aftësi mesatare dhe që punon normalisht të përfitojë të paktën të njëjtën pagë me atë të punëmarrësit që paguhet me kohë dhe që kryen të njëjtën punë (neni 110, pika 2 dhe 3 e KP).

Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 111, pika 1 e KP).

Paga bazë për klasë, gradë apo funksion përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave (*VKM Nr.321 – 326, datë 31.5.2023, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.90, 21 qershor 2023*).